



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 438/4 prot.

Tiranë më 26.4.2018

**VENDIM**

Nr. 19, datë 26.4.2018

**PËR KONTROLLUESIN "2AE" (KLINIKA FIT HEALTH)**

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "2AE" shpk (Klinika FitHealth),

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 96, datë 07.03.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "2AE" shpk (Klinika FitHealth) me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga një qytetar dhe verifikimi i ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar;

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua se:

Kontrolluesi "2 AE" shpk (Klinika FitHealth) me Nipt L32301005D, është një klinikë mjekësore që kryen vizita dhe analiza alergologjike dhe nutricioni (testi i intolerancës ushqimore). Gjatë shërbimit të ofruar për pacientët, në cilësinë e kontrolluesit përpunon të dhëna personale dhe sensitive. Në lidhje me ankesën e paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga ankuesi R. L, nuk u konstatuan shkelje.

Ndërkohë, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në lidhje me përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale rezultoi se kontrolluesi nuk kishte plotësuar detyrimin për njoftim (neni 21).

Nga verifikimi paraprak i kryer në regjistrin elektronik të KDIMDP-së dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit si edhe nga hetimi administrativ i ushtruar rezultoi se kontrolluesi

nuk e kishte përmbushur detyrimin për njoftim në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Kontrolluesi e përmbushi detyrimin për njoftim, por pasi u njoh me urdhrin e Komisionerit për kryerjen e hetimit administrativ pranë tij, ndërkohë që ky është një detyrim që duhet përmbushur përpara fillimit të përpunimit të të dhënave.

Kontrolluesi nuk i informon subjektet e të dhënave personale (pacientët), mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, nenet 12, 13, 15, 16 dhe 17 të ligjit, afatin e mbajtjes së të dhënave, dhe masat e sigurisë. Gjithashtu, nga verifikimi i kryer në faqen online të kontrolluesit, rezultoi të mos jenë publikuar “Politikat e privatësisë”, duke mos u dhënë mundësi subjekteve të të dhënave të informohen mbi mundësinë e ushtrimit të të drejtave të tyre, në kundërshtim me nenin 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale (pacientëve) është një nga detyrimet bazë të kontrolluesit pasi u jep mundësinë atyre që të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë.

Kontrolluesi nuk ka hartuar një “Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale dhe sensitive të pacientëve dhe punonjësve, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Rregullorja duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe të përfshijë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale për çdo kategori subjektësh të të dhënave.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një “Rregulloreje për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, e detyrueshme për çdo punonjës të kontrolluesit, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjekti të dhënash), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj, konsiderohet një detyrim mjaft i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave. Kjo rregullore duhet të jetë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale të kontrolluesit për çdo kategori subjektësh të të dhënave, sipas deklarimeve në “Formularin e Njoftimit”.

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin (datë 05.04.2018), si dhe në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në datën 20.04.2018, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit, është mbajtur seanca dëgjimore.

Në seancë dëgjimore përfaqësuesi i kontrolluesit, paraqiti të formalizuar rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, deklaratën e konfidencialitetit (draft) si dhe informacion për detyrat dhe detyrimet e personelit të klinikës. Dokumentacioni i paraqitur nga kontrolluesi ishte i paplotë dhe nuk e reflektonte përmbushjen e detyrimeve të parashikuara nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Kontrolluesi nuk i ka kundërshtuar konstatimet e Komisionerit por ka deklaruar që mangësitë kanë ardhur si pasojë e mosnjohjes së ligjit. Zyra e Komisionerit vlerëson se ky pretendim nuk përbën shkak për mospërmbushjen e detyrimeve ligjore dhe përjashtimin nga përgjegjësia.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39/1 gërmat “b” dhe “dh”, të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

*b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;*

*dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;*

Kontrolluesi “2AE” shpk (Klinika FitHealth) në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe sipas nenit 39/2, për kundravajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze, ato lidhen me garantimin e përpunimit të ligjshëm të të dhënave, të drejtën e subjekteve të të dhënave për t’u informuar mbi përpunimin e të dhënave të tyre, masa organizative dhe teknike të përshtatshme që duhet të merren për të mbrojtur të dhënat personale, si dhe për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paaautorizuar. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në bashkëpunimin gjatë ushtrimit të hetimit administrativ dhe në reagimin e kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 21, 22, 18, 27, 29, 30, 31, 39/1/b, 39/1/dh, 39/2, 40 dhe 41 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar,

### **V E N D O S A:**

1. Dënimin e kontrolluesit “2AE” shpk (Klinika FitHealth)” me gjobë, në vlerën **20 000 (njëzetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

2. Dënimin e kontrolluesit "2AE" shpk (Klinika FitHealth) me gjobë, në vlerën **20 000 (njëzetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
3. Kontrolluesi "2AE" shpk (Klinika FitHealth) në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e formularit të njoftimit për të gjitha ndryshimet e mundshme në përpunimin e të dhënave personale në vazhdimësinë e aktivitetit të tij.
4. Gjoba arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 26 4.2018

**KOMISIONERI**  
**Besnik Dervishi**

